

MODELET REPUBLIKANE TË ORGANIZIMIT SHTETËROR NË
SHQIPËRI: NJË ANALIZË KRAHASIMTARE E PERIUDHAVE 1925-
1928 DHE 1946-1976

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I HISTORISË

NGA

EDISON HYSENI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

KORRIK, 2026

REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS PËR NIVELIN MASTER

Mentori: *Prof. Asst. Mentor Hasani*

Kandidati: *Edison Hyseni*

Tema: *Modelet republikane të organizimit shtetëror në Shqipëri: një analizë krahasimtare e periudhave 1925-1928 dhe 1946-1976*

Qëllimi i këtij studimi është trajtimi i temës: "Modelet republikane të organizimit shtetëror në Shqipëri: një analizë krahasimtare e periudhave 1925-1928 dhe 1946-1976", ndërsa synimi është për të paraqitur një krahasim të qartë në mes të këtyre dy republikave. Janë të përshkruara dhe shtjelluara modelet qeverisëse dhe forma e organizimit të dy republikave që janë trajtuar, ashtu sikurse edhe zhvillimi ekonomik, ushtarak dhe organizimi i pushteteve (ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor). Përveç kësaj thelbi i temës apo studimit qëndron në analizat dhe krahasimet që janë bërë, si analiza e kushtetutave të kohës përmes cilave funksiononin këto republika, pastaj krahasimi i pushteteve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, duke sqaruar dallimet dhe ngjashmëritë që patën, ashtu sikurse u krahasua edhe organizimi dhe funksionimi i ushtrisë gjatë dy periudha që janë trajtuar, me çka edhe përfundon studimi ynë.

Në fillim të këtij punimi është bërë grumbullimi i literaturës adekuate dhe janë bërë hulumtime të tjera lidhur me literaturën relevante për temën bosht të çështjes së shtruar për studim. Ndërsa më pas ka ndodhur strukturimi i temës e cila është e ndarë në katër kapituj dhe në disa nënkapituj, të cilave u paraprijnë: abstrakti, parathënia (ku shpjegohen qëllimet, metodat, pyetjet hulumtuese dhe hipotezat), lista e fotove dhe tabelave, e shkurtesave dhe hyrja.

Kapitujt kanë këtë përmbajtje strukturore:

1. Në kapitullin e parë të titulluar: "REPUBLIKA PRESIDENCIALE E SHQIPËRISË (1925- 1928)", fillojmë modelin e sajë të funksionimit dhe organizimit shtetëror, duke vazhduar me rrethanat ekonomike dhe socio-kulturore dhe përfshinë një analizë historiko- strukturore të Statutit Themeltar të kësaj republike.

2. Në kapitullin e dytë të titulluar: " REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË (1946- 1976) ", flasim për modelin socialist të kësaj republike, pastaj për kushtetutën e saj, duke i bërë një analizë historiko-strukture dhe zhvillimin ekonomik të kësaj republike, duke sqaruar karakteristikat e saja socialiste.
3. Në kapitullin e tretë të titulluar: " ORGANIZIM I PUSHTETEVE ", flas për rëndësinë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor dhe për krahasimin e këtyre tri pushteteve në mes dy periudhave që kam trajtuar, duke sqaruar dallimet dhe ngjashmëritë mes tyre.
4. Në kapitullin e katërt të titulluar "ORGANIZIMI USHTARAK", kam trajtuar gjendjen dhe organizimin e ushtrisë shqiptare gjatë dy republikave të kohës, duke vazhduar më pas me trajtimin e të përbashkëtave dhe dallimeve të organizimit ushtarak dhe funksionimin e tyre gjatë të dy periudhave.

Në punimin e kësaj teme sa i përket metodave hulumtuese janë përdorur metodat kualitative dhe kuantitative. Ndërsa për të finalizuar temën janë përdorur metodat përshkruese, analitike dhe krahasimtare. Gjithashtu për realizimin e këtij punimi janë shfrytëzuar një sërë burimesh arkivore të cilat janë marrë nga Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH), revista shkencore, punime shkencore, etj., të cilat më kanë ndihmuar në vërtetimin e hipotezave të ngritura, të cilat janë:

1. Si është konceptuar dhe zbatuar forma republikane në të dy periudhat kohore?
2. Cilat ngjashmëri dhe ndryshime ekzistojnë ndërmjet dy modeleve republikane në organizmin shtetëror?
3. Cili ka qenë modeli ndërkombëtar që ka ndikuar ose frymëzuar të dy modelet republikane?
4. Si është përcaktuar roli i ushtrisë në kushtetutat e dy periudhave?